



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Integritim Evropian
Mbledhja nr. 33
Prishtinë, më 08. 04. 2009, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I mbledhjes së Komisionit për Integritim Evropian

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Džezair Murati, Hydajet Hyseni, Sabri Hamiti, Nait Hasani dhe Naser Rugova, por munguan Edita Tahiri, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini dhe Branislav Grbić.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës.**
2. **Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave: 23. 02. 09, 02. 03. 09, 16. 03. 09 dhe 25. 03. 09.**
3. **Takim me ministrin e Punëve të Brendshme Zenun Pajaziti.**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit për zonat ekonomike me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave: 23. 02. 09, 02. 03. 09, 16. 03. 09 dhe 25. 03. 09

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Takim me ministrin e Punëve të Brendshme Zenun Pajaziti

Kryesuesja - Falënderoi ministrin që i është përgjigjur ftesës së Komisionit për të diskutuar për çështjen e liberalizimit të vizave. Gjatë takimit të cilin e kisha në Bruksel frika më e madhe e tyre ishte se qytetarët e Kosovës do t'i marrin pasaportat e Serbisë dhe në këtë mënyrë s'do të mund të kishin kontroll të kufijve. Lidhur me procesin e liberalizimit të vizave për Kosovë, tha: "A duhet

të përmbushim kushte shtesë apo kushtet e parapara për shtetet e tjera?" Po ashtu pyeti se ku gjendet Kosova në përmbushjen e atyre standardeve.

Zenun Pajaziti - Sa i përket procesit të liberalizimit të vizave tha se është proces shumë i rëndësishëm, i cili nuk është komplet në kuadër të Planit për Partneritet Evropian, për shkak se është një proces më i veçantë se procesi i integritimit në BE. Problem në këtë proces paraqet mosnjohja e Kosovës nga disa shtete anëtare të BE-së. Vitin e ardhshëm konsiderohet se disa nga shtetet e rajonit do ta nënshkruajnë marrëveshjen për liberalizim të vizave, mirëpo Kosova nuk është e përfshirë në këtë proces. Duke i marrë para sysh përvojat e vendeve, të cilat kanë kaluar nëpër këtë proces dhe kanë qenë të detyruara ta bëjnë një plan se cilat kritere duhet t'i përmbushin, morëm hap të njëanshëm dhe nga përvojat e tyre hartuam po ashtu një plan. Ky plan pritet të miratohet javën e ardhshme në Qeveri. Sa i përket zbatimit të njëanshëm të këtyre kritereve është pritur shumë mirë nga përfaqësuesit e BE-së në Bruksel. Kriteret e liberalizimit të vizave, janë të shumta: përfshirja në luftën kundër krimit të organizuar, menaxhimi i integruar i kufijve, lufta kundër korrupsionit dhe reformat në gjendjen civile. Në kuadër të këtij kriteri hyn edhe siguria e dokumenteve. Sa i përket planit, i cili është hartuar për këto kritere do t'ia dorëzojmë secilit institucion, në mënyrë që të ndërmerren hapa të nevojshëm për plotësimin e kritereve të kërkuara. Çështja e dokumenteve është një ndër kriteret për të cilin kemi krijuar besim te BE-ja, sepse janë dokumente të një sigurie të lartë, kurse sa i përket vendosjes së çipit është më shumë çështje teknike. Njoftoi se kanë shprehur shqetësim se Kosova dhe qytetarët e saj do të izoloohen në rast se Serbia dhe Maqedoni do ta nënshkruanin marrëveshjen e liberalizimit të vizave. Serbia në Kosovë ka disa zyra të cilat lëshojnë pasaportat e Serbisë. Sa i përket mbylljes së këtyre zyrave të Serbisë në Kosovë, i kemi njoftuar se kjo mund të ndodhë brenda disa minutave, por një gjë e tillë do të bëhet në bashkëpunim me përfaqësuesit ndërkombëtarë.

Dzezair Murati - Falënderoi ministrin për atë që ka bërë për sigurinë e të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa dallim etnie. Shtoi se ka informata nga komuniteti që e përfaqëson se është shumë i kënaqur për raportin policë qytetarë, si dhe për trajtimin që u bëhet boshnjakëve në kalimin e kufirit. Tha se zyrtarisht mund të deklaronte se siguria e komunitetit boshnjak është në nivelin më të lartë. Si përfaqësues i komunitetit boshnjak shprehu falënderim për ministrin, sepse në çdo takim kishte hasur në mirëkuptim. Në vazhdim ngriti çështjen e pranimit të pasaportave të Kosovës nga Bosnja dhe Hercegovina, meqë tani as pasaportat e UNMIK-ut nuk po pranohen. Sa i përket komunitetit boshnjak, shtoi se ata do të na i pranonin pasaportat, por komuniteti i tretë është prapa, andaj edhe nuk ka konsensus. Për këtë duhet të bëhet një vizitë në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ishte i interesuar që dokumentet tona të udhëtimit të jenë të pranueshme, andaj në kontaktet me bashkësinë ndërkombëtare duhet të bëhet trysni në Bosnjë, në mënyrë që të na e njohin pasaportën e Republikës së Kosovës.

Naser Rugova - Konsideroj se keni bërë punë shumë e madhe në këtë drejtim dhe ju inkurajoj të vazhdoni. Ekzistojnë disa probleme serioze të natyrës politike, sa i përket procesit të liberalizimit të vizave, kemi dhënë shembull që nga viti 2001, kur kemi filluar prodhimin e dokumenteve, të cilat janë vlerësuar se janë të cilësisë së lartë. Në rajon jemi njohur si qytetarë me dokumente shumë të sigurta. Po ashtu edhe dokumentet, të cilat po lëshohen tani, janë të një sigurie të lartë. Shprehu shqetësim sa i takon nënshkrimin të marrëveshjes së liberalizimit të vizave nga ana e Serbisë, për shkak se një numër i madh i qytetarëve të Kosovës janë të pajisur me pasaporta të Serbisë. Në këtë mënyrë do të zbehet imazhi i shtetit të Kosovës. Lidhur me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit tha se ministria të cilën e drejtoni mund të ketë një numër shumë të vogël të aktiviteteve, sepse jeni të fundit që duhet të ndërmerri veprime. Kërkoj të përshpejtohen reformat në gjendjen civile, sepse kjo do ta lehtësonte dhe do ta ndihmonte shumë edhe dikasterin të cilin e mbulon kjo ministri. Kështu do të mënjanohehin radhët e gjata të pritjes për dokumente. Kërkoj të shqyrtohet mundësia e liberalizimit të vizave me Kroacinë, sepse atje është edhe komuniteti shqiptar dhe marrëdhëniet me Kroacinë janë të

shkëlqyeshme. Duhet të nënshkruhet një marrëveshje me ministrin e Punëve të Jashtme dhe me Ambasadën e Kroacisë. Kjo marrëveshje duhet të zyrtarizohet.

Hydajet Hyseni – Me gjithë faktin se ka probleme shumë të mëdha, kjo ministri ka arritur të ndërmarë hapa shumë të suksesshëm. Kërkoj t'i kushtohet vëmendje më e madh mërgatës, sepse përballat me probleme shumë të mëdha, sa i përket pajisjes me dokumente udhëtimi, si në Kosovë ashtu edhe në vendin ku jetojnë. Mërgata duhet të paguajë sigurim të veçantë. Sa i përket pajisjes me dokumente të identifikimit i mbështes lehtësimet që u janë bërë. Ka ankesa shumë të mëdha të qytetarëve, që detyrohen ta paguajnë sigurimin shëndetësor dhe atë vetëm për qytetarët me dokumente të Republikës së Kosovës e jo edhe për ata të cilët kanë dokumente të paligjshme. Problemi i qarkullimit në viset shqiptare kërkon kujdes shumë të madh dhe duhet të funksionojë instrumenti i reciprocitetit. Në fund tha se nuk është aktualizuar çështja e ndalesave që u bëhen qytetarëve të Kosovës, madje edhe atyre me dokumente të UNMIK-ut. Edhe qytetarët serbë kanë pengesa për të cilat duhet ta ngrejë zërin më shumë, sidomos Qeveria e Kosovës. Nuk duhet të kufizohemi vetëm në akte politike, pasi për mua nuk është shumë e rëndësishme se a po hyn një deputet ose një politikan i Serbisë. Po u kufizua vetëm në këtë çështje, do të ishim terren problematik dhe më e rëndësishme do të ishte a po hyjnë krimi i organizuar, kontrabanda dhe armët. Ka shenja se të gjitha këto janë të pranishme. Vendosja e parimeve ndërshtetërore me partnerët ndërkombëtarë është nevojë e pashmangshme.

Bujar Bukoshi – Mos ngurroni të na i paraqitni problemet me të cilat po ballafaqoheni. Është e pamundur të ketë funksionalizim të jetës pa funksionim të mirë të resorit të cilin ju e udhëhoqni. Kërkoj t'i paraqesin prioritetet në mënyrë që të mund të ndihmojnë dhe të jenë më të zëshëm, sepse nuk e kanë kontrollin e territorit të vet dhe të kërkojnë t'i marrin kompetencat.

Zenun Pajaziti – Theksoi se kriter kryesor në procesin e liberalizimit është edhe nënshkrimi i marrëveshjeve të riatdhesimit. Njoftoi se ka kërkuar që Kosova të hyjë për këtë proces në BE, sepse negociimi me secilin shtet veç e veç është shumë i vështirë. Kjo nuk është arritur dhe sugjerimi i fundit ka qenë se duhet të negociohet me secilin shtet veç e veç. Sa i përket nënshkrimit të marrëveshjeve për riatdhesim me disa shtete, duhet t'i nënshkruajmë marrëveshjet e me disa t'i zvarrisim sa më gjatë. Lidhur me këtë kemi mirëkuptim me një numër të madh të shteteve. Me ligj qytetarët e Kosovës kanë të drejtë për dy shtetësi, andaj nuk kemi të drejtë t'ua mohojmë qytetarëve të marrin pasaportë të Shqipërisë ose të Serbisë. Shqetësimi ynë është se Serbia po i lëshon dokumentet pa i identifikuar. Sa u përket pasaportave të Kosovës, për ne është lehtësim shumë i madh njohja e pasaportave nga shtetet të cilat ende nuk na kanë njohur. Sa i përket reformimit në gjendjen civile kemi trashëguar mekanizëm që vështirë reformohet. Shtoi se pajisja me dokumente udhëtimi na detyroi ta zgjatim orarin e punës dhe afati zyrtar për t'u pajisur me dokumente është 2 javë. Është edhe projekti për digjitalizimin e disa shërbimeve. Çështja e sigurimit të cilin e paguajnë qytetarët tanë nuk është në kompetencë tonën, sepse Maqedonia një hap të tillë e ka bërë në mënyrë të njëanshme. Me vendosjen e masave të reciprocitetit, do t'i dëmtonim qytetarët tanë. Për sigurimin, të cilin duhet ta paguajë mërgata, kam rekomanduar që ky veprim të hiqet që nga viti i kaluar.

Kryesuesja - Kërkoj të ofrohen me shkrim të arriturat e kësaj ministrie, duke u përqendruar në ato të cilat kanë dalë nga sfidat e Raporti të Progresit.

Zenun Pajaziti - Puna e parë që kemi bërë, pasi u publikua Raporti i Progresit, ka qenë rishikimi i Planit të punës dhe harmonizimi i tij me sfidat që dalin nga Raporti i Progresit. Premtoi se do të dërgohen me shkrim të arriturat për të gjitha fushat që i mbulon ky dikaster.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për zonat ekonomike me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryesuesja – E ftoi deputetin Bujar Bukoshi - referues i këtij projektligji, ta paraqesë raportin lidhur me përputhshmërinë me *Acquis Communautaire*.

Bujar Bukoshi – Theksoi se në mbështetje të Divizionit të Standardizimit e kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe kjo i është lënë secilit shtet që këto çështje t'i rregullojë vetë në baza kombëtare.

Kryesuesja - Konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundim

Projektligji për zonat ekonomike, me amendamente të Komisionit Funkcional, nuk i cenon parimet themelore të Acquis Communautaire dhe politikat e BE-së.

5. Të ndryshme

a) Caktimi i vizitave zyrtare

Kryesuesja - I njoftoi anëtarët e Komisionit se Komisioni Evropian do ta mbështesë Komisionin që në përbërje prej 4 deri 5 deputetësh t'i realizojë dy vizita. Kërkoj nga deputetët të propozojnë se parlamentet e cilave shtete do t'i vizitojnë.

Pas diskutimit të deputetëve u nxor ky

Përfundim

Vizitat do të realizohen në Slloveni dhe në Estoni. Listat e pjesëmarrësve do të caktohen në mbledhjen e radhës.

b) Organizimi i tryezës rajonale

Kryesuesja - I njoftoi anëtarët e Komisionit se në tetor do të organizohet tryezë rajonale në Prishtinë për përkthimin e *Acquis Communautaire*.

c) Hartimi i raportit për seancë plenare

Kryesuesja - Njoftoi se në javën e ardhshme planifikon të organizojë një *work shop* për hartimin e raportit, i cili do të paraqitet në seancë plenare. Shtoi se kryetarët e komisioneve kanë vendosur që vërejtjet dhe propozimet e tyre për Planin e veprimit t'i dërgojnë nëpërmjet Kryesisë së Kuvendit.

d) Propozimi për takim me zyrat e integritimeve evropiane në Ministri

Nait Hasani - Kërkoj të dinte cili është bashkëpunimi me zyrat për integritime evropiane që janë të vendosura nëpër Ministri. Propozoi të realizohen vizita në këto zyra me qëllim të njoftimit më të hollësishëm për punën që e bëjnë ato.

Kryesuesja – Theksoi se të gjitha zyrat për integritime i raportojnë Agjencisë së Integritimeve dhe se janë ftuar ministrat e nivelit më të lartë, andaj nuk e konsideroi të domosdoshëm realizimin e

vizitave në këto zyra. Shtoi se për ta realizuar këtë objektiv janë caktuar deputetët që të marrin pjesë në grupe pune të PVPE-së.

Naser Rugova – E përkrahu propozimin e deputetit Hasani. Shtoi se pas vërejtjeve të Raportit të Progresit ka filluar një mobilizim i madh i të gjitha ministrive. Me gjithë atë shihet se përsëri ka rënie.

e) Njoftim i deputetit Bujar Bukoshi për konferencën e mbajtur në Gjermani

Bujar Bukoshi - Njoftoi se konferenca, që ishte e ndarë në tri panele, është mbajtur në Gjermani nga Asambleja për Siguri më 2 prill. Nga ajo konferencë kanë dalë disa konkluzione për dobësitë e EULEX-it.

f) Kërkesë e deputetit Naser Rugova për vizë

Naser Rugova - E luti kryetaren ta bënte një kërkesë në emër të Komisionit, që t'i jepet notë verbale, në mënyrë që t'i mundësohet të marrë e vizë, sepse kjo çështje ishte shtyrë që dy muaj.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40 min.

E hartoi:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit

Zylfije Hundozi